



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 24.11.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “A R J E I L” sh.pk, me NUIS K31320002C, me adresë: Kamëz, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-09119-10-22-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pllaka dhe bordura”, me afat lëvrimit nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.12.2021, me fond limit 27.852.200 (njëzetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 158, datë 01.11.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**BAÇI - EL 2003 SH.P.K**” sh.p.k, me NUIS K42724211C, me adresë: Fshati Katundi i Ri, Komuna Bradashesh, Elbasan dhe me ofertë ekonomike 20.889.160 (njëzet milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “**GJONI – AN**” sh.p.k, me NUIS K92223011V, me adresë: Tirane Zall Herr PINAR Lagjja Pinar, Rruga Zall - Herr i Ri, Godinë 3 katëshe me numër 3, Kati i parë dhe me ofertë ekonomike 21.168.600 (njëzet e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**ZDRAVO**” sh.p.k, me NUIS J84003411K, me adresë: Fier Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Ish godina e plastmasit dhe me ofertë ekonomike 21.352.300 (njëzet e një milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik “**A R J E I L**” sh.p.k, me NUIS K31320002C, me adresë: Kamëz, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 21.358.350 (njëzet e një milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**BAÇI - EL 2003 SH.P.K**” sh.p.k, me NUIS K42724211C për arsytet e mëposhtme:

Nuk përmbush pikën pikën 2.3.4 kapaciteti teknik ku parashikohet se “*Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës*”

<i>Nr.</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>1</i>	<i>Kamion me vinç me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton</i>	<i>1</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik ka marrë me qera mjetin me targë AA946 HL nga shoqëria “**BAJRAMI N**” sh.p.k. Mjeti është i pajisur me certifikatë për transport mallrash **për vete** brenda vendit me Nr.72/22, datë 31.05.2021 lëshuar nga Bashkia Elbasan në përdorim të personit juridik “**BAJRAMI -N**” sh.p.k. Gjithashtu në lejen e qarkullimit, destinacioni i mjetit rezulton për përdorim vetjak.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. **Transport për vete:** transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. **Transport për të tretë dhe me qira:** transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”

Ligji “Për Transportet Rrugore”,bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikata e mjetit me targë AA 946 HL të cilën e disponon shoqëria “BAJRAMI –N ” sh.p.k., sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete (vetjak) , përmes së cilës është i licencuar vetëm ky subjekt dhe është dhënë në përdorim në emër të personit juridik “BAJRAMI –N” sh.p.k, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë “BACI EL 2003 ” sh.p.k të mallrave me mjetin e sipërcituar të shoqërisë “BAJRAMI –N” sh.p.k do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

Gjithashtu ne shtojcën 8, në pjesën e tretë, ku deklarohen të dhënat e mjetit nuk janë shënuar të dhënat konkrete të mjetit. Në këto kushte KVO-ja ka vlerësuar dokumentacionin e mjetit me targë AA946 HL të ngarkuar në SPE, çertifikata e transportit të së cilit është konstatuar e pavlefshme sipas shpjegimeve të mësipërme.

2. **Operatori ekonomik “GJONI – AN” sh.p.k, me NUIS K92223011V** për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit, për produktet e betonit sipas standartit SSH EN 1338, për produktet prej mermeri/guri sipas standartit SSH EN 196, nga laboratorë të çertifikuar dhe akredituar, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike. Për standartet e përmendura pranohet dhe ekuivalenti i tyre.*

Dokumentacioni teknik i cili shoqëron kontratën e furnizimit të lidhur midis operatorit pjesëmarrës dhe shoqërisë ”Vëllezërit Kasa” sh.p.k nuk është i përkthyer në gjuhën shqipe, në kundërshtim me parashikimet në dokumentat standarte të tenderit. Konkretisht në pikën 7, seksioni 4 të Njoftimit të Kontratës dhe në Seksionin I, pika B ”Përgatitja e ofertave”, shkronja 2, ”Gjuha e ofertës” parashikohet se gjuha në të cilën duhet të përgatitet oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentat në lidhje me procedurën e prokurimit duhet të jetë gjuha shqipe. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim. Në këto kushte KVO-ja nuk mund të vlerësojë përmbushjen e këtij kriteri për mallrat e furnizuara nga shoqëria ”Vëllezërit Kasa” sh.p.k.

3. Operatori ekonomik “ZDRAVO” sh.p.k, me NUIS J84003411K për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën pikën 2.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku parashikohet se *"Deklaratë nga Operatori Ekonomik për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore)."*

Sipas ekstraktit të QKB –së operatori ekonomik “ZDRAVO” sh.p.k ka si vënd tjetër ushtrimi aktiviteti në adresën:*Shkoder Bulevardi 'Mehmet Pash Plaku' Lagjja Nr.04,4001,Zk 8594,Nr Pasurie*. Operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore vetëm për adresën e Lushnjës, ndërsa për adresën Shkodër nuk ka paraqitur as deklaratë dhe as vërtetim për shlyerjen e taksave vendore.

2.Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij."* Operatori ekonomik ”ZDRAVO” sh.p.k ka deklaruar se është prodhues i pllakave të trotuarit, bordurave etj. Nga verifikimi i ekstraktit të QKB –së, operatori ekonomik nuk rezulton prodhues i mermerit, gurit ose/dhe pllakë, tip terracotë dhe nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për këto mallra.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “A R J E I L” sh.p.k, me NUIS K31320002C, me adresë: Kamëz,Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 21.358.350 (njëzet e një milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferte e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.